



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 100 Prot.

Tiranë, më datë 04.02.2021

VENDIM
Nr. 27, datë 04.02.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *"Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 *"Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale"* dhe Urdhrit Nr.223, datë 03.07.2020 *"Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të saj"*, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 04.02.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit *"Përmirësimin e ambjenteve të laboratorit të veprave të artit pranë Muzeut Onufri"*, Berat, me aplikues DRTK Berat;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, *"Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRËTAR
Arta DOLLANI

